




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/197
Datë: 25.09.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 shtator 2014, mori:


V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet 191, 192, 193 dhe 194 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

 Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/197
Datë: 25.09.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 shtator 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për përcaktimin e kostos së shpenzimeve të transportit të mallërave të importuara.
2. Obligohen Ministria e Financave dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

per Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës
Hashim Thaçi

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/197

Datë: 25.09.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 shtator 2014, mori:

V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R

1. Aprovohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Linjës Energetike 400 kV Kosovë-Shqipëri, segmenti II-dytë 32 km, Zonat Kadastrale Gllanasellë, Çikatovë e Vjetër, Gllobar, Domanek, Krajkovë, Llapushnik, Negroc, Arllat të Komunës së Drenasit dhe Zonat Kadastrale Balincë, Vermicë, Shkarashnik, Llashka Drenovc, Carrallukë, Mirushë, Dragobil, Burim dhe Gurbardh të Komunës së Malishevës, sipas tabelave të bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat të bashkëngjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
5. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cildo person i cili është pronar ose zotërues i interesit, ne pronën e paluajtshme ose të

drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi.

6. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që 5 (pesë) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në zyrën ligjore të Organit përkatës Shpronësues, nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron në përputhje me këtë paragraf, gjykata e refuzon ankesën.
7. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Kompania Publike "Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut" Sh.A (KOSTT) do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

pc Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Bujar Buz

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/197

Datë: 25.09.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 31, paragrafi 8 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 shtator 2014, mori:

V E N D I M

1. Emërohet Paneli i Posaçëm (ad hoc) për identifikimin dhe rekomandimin e kandidatëve për anëtarë të Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike, në këtë përbërje:

1.1. Këshilltar (ZKM),	kryesues;
1.2. Sekretar i Përgjithshëm (MI)	anëtar;
1.3. Këshilltar (MI),	anëtar;
1.4. Këshilltar (MPB),	anëtar;
1.5. Këshilltar (MF),	anëtar.
2. Paneli i Posaçëm (ad hoc) ka obligim të identifikoj dhe t'i rekomandoj Qeverisë kandidatët për anëtarë të Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që të shpall konkurs publik për anëtarë të Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

për
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/197

Datë: 25.09.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 shtator 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave në Republikën e Kosovës.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

per Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/197

Datë: 25.09.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr. 18/19 shtator 2011), duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 25 shtator 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Punëve të Brendshme për vazhdimin e kontratës së re të mirëmbajtjes së sistemit të përgjimit ligjor të Policisë së Kosovës për periudhën dy vjeçare shtator 2014 - shtator 2016.
2. Për shkak të kërkesës së përdorimit të masave të veçanta të sigurisë lejohet përjashtimi i procedurave të rregullta në pajtim me Nenin 3 të Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik në Republikën e Kosovës.
3. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi në pajtim me Legjislacionin në fuqi.
4. Të gjithë zyrtarët e kyçur në mirëmbajtjen e sistemit të përgjimit ligjor të Policisë së Kosovës dhe ngritjen e kapaciteteve të Policisë në këtë fushë, mbajnë përgjegjësinë individuale për vendimet që marrin në fushat e përgjegjësive të tyre për zbatimin e kësaj kontrate.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

per Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Bujar Boshnjak

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë